

VENDIM
Nr. 615, datë 30.7.2026

**PËR SHPALLJEN “ZONË E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK,
‘Vlorë TEDA/RAMS Free Zone’” DHE ZHVILLUESIT TË ZONËS ME
VENDNDODHJE NË Vlorë**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, dhe të nenit 14/2, të vendimit nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik ‘Vlorë TEDA/RAMS Free Zone’” të territorit me sipërfaqe 885 557.6 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë gjashtë) m², pjesë e zonave kadastrale 8604 dhe 2765, në Bashkinë Vlorë, të përbërë nga pasuritë me sipërfaqet përkatëse, sipas listës dhe hartës që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik ‘Vlorë TEDA/RAMS Free Zone’” përcaktohen në hartën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë, që do të zhvillohen në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik ‘Vlorë TEDA/RAMS Free Zone’”, janë të llojit:

- a) ekosistem industrial logjistik dhe inovativ;
- b) teknologji industriale;
- c) automatizim dhe inteligjencë artificiale;
- ç) përpunim mekanik i lehtë i metaleve, duke kombinuar metalurgjinë e pastër me aktivitete të kufizuara në përpunim mekanik të lehtë dhe trajtime sipërfaqësore jondotëse dhe energjinë e rinovueshme.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 (tridhjetë e pesë) vjet, me të drejtë përsëritjeje deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

5. Ministria përgjegjëse për ekonominë vë në dispozicion pasuritë e paluajtshme shtetërore në zonat kadastrale 8604 dhe 2765, Bashkia Vlorë, me sipërfaqe totale 885 557.6 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë gjashtë) m², pjesë e Fondit të Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS), në funksion të zhvillimit të projektit, me tarifë 1 (një) euro/kontrata.

6. Shoqëria “RAMS Albania” sh.p.k. shpallet zhvillues i zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, me procedurë jokonkurruese si subjekt përfitues, me status “Investim/investitor, procedurë e veçantë”, në bazë të vendimit nr. 1, datë 11.2.2026, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar.

7. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 4.6.2008, “Për shpalljen e ‘Zonës ekonomike’ në Vlorë”, nr. 818, datë 11.6.2008, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, në Vlorë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, dhe nr. 1547, datë 26.11.2008, “Për miratimin e kontratës të formës BOT, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë

dhe Energjetikës dhe ‘Idea Vlora’ sh.a., për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e parkut industrial në Vlorë”, shfuqizohen.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore Kadastrës dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “VLORË TEDA/RAMS FREE ZONE”

Nr.	Zona kadastrale	Zona	Numër pasurie	Volum	Faqe	Sipërfaqe m²	Statusi
1	2765	Nartë	997	6	44	5 000	Shtet
2	8604	Vlorë	45/10	11	50	37	Shtet
3	8604	Vlorë	45/11	11	51	38	Shtet
4	8604	Vlorë	45/13	11	53	38	Shtet
5	8604	Vlorë	45/30	13	77	10 644	Shtet
6	8604	Vlorë	45/31	13	78	8 278	Shtet
7	8604	Vlorë	45/8	13	96	37	Shtet
8	8604	Vlorë	45/9	13	97	38	Shtet
9	8604	Vlorë	45/51	28	35	7 776	Shtet
10	8604	Vlorë	45/29/1	31	183	7 990	Shtet
11	8604	Vlorë	45/19/2	31	192	2 698.7	Shtet
12	8604	Vlorë	45/32/1	31	196	8 760	Shtet
13	8604	Vlorë	45/32/2	31	197	1 593	Shtet
14	8604	Vlorë	45/27/1	31	198	9 126	Shtet
15	8604	Vlorë	45/27/2	31	199	459	Shtet
16	8604	Vlorë	45/1/2	31	206	3 867	Shtet
17	8604	Vlorë	45/54	32	6	115 298.8	Shtet
18	8604	Vlorë	45/55	32	7	117 130.3	Shtet
19	8604	Vlorë	45/56	32	8	133 451.8	Shtet
20	8604	Vlorë	45/49/4	72	201	120 641	Shtet
21	8604	Vlorë	45/1/4	72	202	211 326	Shtet
22	8604	Vlorë	45/46/4	491	221	121 330	Shtet
SIPËRFAQE TOTALE						885 557.6	

